



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: *Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Qendër, Qok, Miroc, Gacafer, Berishë 7 Shtatori*

Nr. i Prokurimit:	636-25-2268-5-2-1
Nr. i Brendshëm	636-25-009-521

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ²
1.	"MONDI " SH.P.K.	70,001.50€
2.	"V - SHEHU " SH.P.K.	65,555.55€
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik Q SHALA SH.P.K.; BERISHA COM SH.P.K.	59,970.00€
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik ARFA GROUP SH.P.K.; V Gaxherri Group SH.P.K.	67,080.00€
5.	N.P. " Auremont "	66,215.00€

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna Junik e shpërblen me kontratë "V - SHEHU " SH.P.K. në vlerë totale të ofertës 65,555.55€

Data: 28.04.2025

Emri dhe mbiemri i ZPP: Egronit Gaxherri

¹ Këtë formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

² Në rast të procedurave të kufizuara/procedurave konkurruese me negociata t'i bashkangjiten letrat standarde të njoftimeve: B43 dhe B44.(shtu letra standarde sipas nevojës), derisa kolona "Vlera totale e ofertave" nuk plotsohet më të dhena.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm⁴

Data:28.04.2025

AK- Komuna Junik

GOE: "V - SHEHU " SH.P.K.

Nr. i Prokurimit:	636-25-2268-5-2-1
Nr. i Brendshëm	636-25-009-521

Titulli: Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Qendër, Qok, Miroc, Gacafer, Berishë 7 Shtatori

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar *tenderin me çmimin më të ulët* si përgjigje ndaj *njoftimit të kontratës* për aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj me vlerë prej **65,555.55€** dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit të intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

⁴ Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

B46 - Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm⁵

Data:28.04.2025

AK- Komuna Junik

GOE: Grup i Operatorëve Ekonomik ARFA GROUP SH.P.K.; V Gaxherri Group SH.P.K.

Nr. i Prokurimit:	636-25-2268-5-2-1
Nr. i Brendshëm	636-25-009-521

Titulli: Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Qendër, Qok, Miroc, Gacafer, Berishë 7 Shtatori

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk qe tenderi me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë "V - SHEHU " SH.P.K. për një shumë prej **65,555.55€** .

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

⁵ Kjo letër u drejtohet tenderuesve që i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktues, të paraqitura në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit, por të cilëve nuk u është dhënë kontrata, ngase tenderët e tyre nuk qenë nga më të mirët sipas kriterit për dhënie të kontratës.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ⁷

Data: 28.04.2025

AK- Komuna Junik

GOE: N.P. " Auremont "

Nr. i Prokurimit:	636-25-2268-5-2-1
Nr. i Brendshëm	636-25-009-521

Titulli: Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Qendër, Qok, Miroc, Gacafer, Berishë 7 Shtatori

Le nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në **dosjen e tenderit**. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

*Bazuar në raportin e vlerësimit të ofertave, Komisioni Vlerësues ka konstatuar se Operatorit Ekonomik N.P. "Auromont" i mungon dokumentacioni i nevojshëm për të përmbushur kërkesën numër 6 të Dosjes së Tenderit, e cila ka të bëjë me **angazhimin e personelit profesional**.*

Sipas kësaj kërkesë:

"Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme:

- Udhëheqës i punishtes – Inxhinier i diplomuar i hidroteknikës me së paku 3 vite përvojë pune;*
- Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – me së paku 3 vite përvojë pune."*

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatorit Ekonomik N.P. "Auromont", është konstatuar se:

- Për Inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë, nuk është dorëzuar asnjë kontratë pune apo marrëveshje për angazhim me Operatorin Ekonomik, dokument ky i domosdoshëm për të vërtetuar angazhimin e këtij personeli në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit.*

Mungesa e dokumentacionit të lartpërmendur përbën mospërmbushje të kritereve të kërkuara, dhe rrjedhimisht, në përputhje me nenin përkatës të Ligjit për Prokurimin Publik dhe specifikimet e dhëna në Dosjen e Tenderit, oferta e Operatorit Ekonomik N.P. "Auromont" është konsideruar i pa përgjegjshme dhe eliminohet.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

⁷ *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).*



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ⁶

Data:28.04.2025

AK- Komuna Junik

GOE: "MONDI" SH.P.K.

Nr. i Prokurimit:	636-25-2268-5-2-1
Nr. i Brendshëm	636-25-009-521

Titulli: *Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Qendër, Qok, Miroc, Gacafer, Berishë 7 Shtatori*

l/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në **dosjen e tenderit**. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

Bazuar në raportin e vlerësimit të ofertave, Komisioni Vlerësues ka konstatuar se Operatorit Ekonomik "MONDI" SH.P.K i mungon dokumentacioni i nevojshëm për të përmbushur kërkesën numër 6 të Dosjes së Tenderit, e cila ka të bëjë me angazhimin e personelit profesional.

Sipas kësaj kërkesë:

"Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme:

- Udhëheqës i punishtes – Inxhinier i diplomuar i hidroteknikës me së paku 3 vite përvojë pune;*
- Inxhinier i diplomuar i ndërtimitarisë – me së paku 3 vite përvojë pune."*

Pas vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatorit Ekonomik "MONDI" SH.P.K, është konstatuar se:

- Përsoni i propozuar për udhëheqës të punishtës nuk është inxhinier i diplomuar i Hidroteknikës nuk është dorëzuar asnjë kontratë pune apo marrëveshje për angazhim me Operatorin Ekonomik, dokument ky i domosdoshëm për të vërtetuar angazhimin e këtij personeli në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit.*

Mungesa e dokumentacionit të lartpërmendur përbën mospërmbushje të kriterëve të kërkuara, dhe rrjedhimisht, në përputhje me nenin përkatës të Ligjit për Prokurimin Publik dhe specifikimet e dhëna në Dosjen e Tenderit, oferta e Operatorit Ekonomik "MONDI" SH.P.K, është konsideruar i pa përgjegjshme dhe eliminohet.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

⁶ *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e metutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).*



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar³

Data: 28.04.2025

AK- Komuna Junik

GOE: Grup i Operatorëve Ekonomik Q SHALA SH.P.K.; BERISHA COM SH.P.K.

Nr. i Prokurimit:	636-25-2268-5-2-1
Nr. i Brendshëm	636-25-009-521

Titulli: *Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Qendër, Qok, Miroc, Gacafer, Berishë 7 Shtatori*

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në **dosjen e tenderit**. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

Gjatë vlerësimit të dokumentacionit të ofertës së paraqitur nga ju si grupi i operatorëve "Q-SHALA" SH.P.K & "BERISHA COM" SH.P.K, janë ngritur dyshime nga komisioni vlerësues mbi autenticitetin e kontratës së punës të ofruar për Inxhinierin e Hidroteknikës, z. Avdi Kusari. Kontrata e paraqitur përmbante nënshkrim që nuk përputhej me nënshkrimin në CV-në e të njëjtit person, duke shtuar dyshimet për falsifikim.

Me kërkesë të Komisionit, Zyra e Prokurimit verifikoi dokumentin duke kontaktuar drejtpërdrejt inxhinierin në fjalë. Përmes bisedës telefonike dhe më pas me përgjigje zyrtare me shkrim përmes emailit, ai konfirmoi se:

- *Nuk ka lidhur ndonjë kontratë pune me kompaninë tuaj, dhe*
- *Nuk e ka nënshkruar kontratën që është prezantuar në ofertë.*

Bazuar në këtë, Autoriteti Kontraktues konstatoi se është paraqitur një dokument i falsifikuar, prandaj në përputhje me nenin 26.14 të Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, është marrë vendim për eliminimin e ofertës tuaj.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

³ *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).*